

Studentët nga Kosova do të marrin pjesë në garën studimore në Austri

Dija peshohet në Vjenë

Prishtinë, 7 shkurt - Për herë të katërt në Kosovë, me mbështetjen e Agjencisë Austriake të Kooperimit, organizata për edukim "Wus-Austria" e organizon garën studimore "Rasti Sfidues i Kosovës 2008". Për dallim nga viti i kaluar, kësaj radhe kjo garë do të përbëhet nga tri pjesë - trajnimi për aplikues, ku fituesit nga çdo disiplinë do të selektohen për "Rastin Sfidues të Ballkanit", që do të mbahet në Vjenë, dhe ngjarja e rekrutimit (punësimit). Gara do të zhvillohet në katër disiplina garuese -

simulim gjyqi, biznes, modeli i Këshillit të Evropës që zëvendëson modelin e Kombeve të Bashkuara të viteve të kaluara dhe në teknologjinë informative dhe komunikuese.

Drejtori i "Wus-Austria", But Dedaj, tha se të drejtë aplikimi kanë të gjithë studentët e arsimit të lartë në Kosovë që ndodhen në vitin e fundit të studimeve apo i vijnë studimet master. Por, sipas tij, nuk u mohohet e drejta e konkurrimit as studentëve të viteve paraprake që kanë sukses të dalluar dhe njohin gjuhën angleze, e

cila është kriter për pjesëmarrje në këtë garë. "Kjo është një sfidë për studentët tanë që dijen e fituar në teori ta zbatojnë edhe në praktikë me raste konkrete, si dhe të vlerësohet se sa janë të përgatitur për t'u përballur me tregun e punës". Dedaj tha se këtë herë do të përdoret edhe një metodë e re. "Nga përfaqësues të kompanive private e publike që janë partnerë në organizimin e kësaj gare, studentëve garues do t'u prezantohet një problem i cilësdo kompani dhe gjatë dy ditëve ata do të kenë rast

të japin idenë e tyre se si do të dilet nga problemi, gjë që do të ndikojë pozitivisht në punësimin e tyre në atë kompani apo mbulimin e studimeve master". Aplikimi do të zgjasë deri më 31 mars, ndërkohë studentët mund të aplikojnë nëpërmjet adresës elektronike të kësaj organizate. Juria, e cila do të bëjë përzgjedhjen e tyre, do të përbëhet nga gjyqtarë, prokurorë, biznesmenë dhe ekspertë të lëmenjve përkatës. Gara do të mbahet më 10 dhe 11 maj. (a. kadriu)

"LAJM" - 08.02.2008 pg. 8